



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 407/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën, e Lëvizjes Vetëvendosje me seli në Prishtin, paraqitur kundër subjektit politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK) ne lidhje me shkeljen e Rregullës Nr.11/2009-Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në seancën e mbajtur me datë 12.12.2010 mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje.

ARSYETIMI

Më 09 Dhjetor 2010, PZAP ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosja, ka parashtruar ankesë në të cilën pretendohet se anëtarët e subjekti politik PSHDK-PDK, me date 9 Dhjetor 2010 Prishtine, ne orën 11:00 tek Tre Sheshirat kane mbuluar posterat e Lëvizjes Vetvendosja, duke bere shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një foto si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregulla dhe Procedurat e PZAP-it neni 3.6 pika c parasheh:

c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit;

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara për shkak se fotoja e bashkangjitur si dëshmi, nuk ofron dëshmi të mjaftueshme dhe të hollësishme për të besuar se ka ndodhur mbulimi i posterave nga subjekti politik PSHDK. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 407/2010 më datën 12.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Muhamet Rexha

